



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:200838

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05768024

KPPP.nr. 1269/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbarimore të kreditorit N.P.L “Pallati i Rinisë” Sh.A., me numër të biznesit 810962052 me seli në Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj” p.nr, kundër debitorit D.P.T “Bela”, me numër unik identifikues 811523796 me seli në Prishtinë, rr. “Luan Haradinaj”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Arbër Osmanaj, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me kërkesën e debitorit për kthim në gjendje të mëparshme dhe prapësimin e paraqitur ndaj Urdhrit Përmbarimor P.nr. 843/21, i lejuar me datë 27.04.2021, nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 03.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit D.P.T “Bela”, me numër unik identifikues 811523796 dhe seli në Prishtinë, ashtu që Urdhri Përmbarimor P.nr. 843/21, i lejuar me datë 27.04.2021, nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, ANULOHET.
- II. HEDHET poshtë kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e paraqitur nga debitori D.P.T “Bela”, me numër unik identifikues 811523796, për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e Prapësimit ndaj Urdhrit P.nr. 843/21, i lejuar me datë 27.04.2021, nga Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, SI I PALEJUAR.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme, Faturës nr. 9/3/2020, e datës 22.09.2020; Faturës nr. 9/8/2020, e datës 18.08.2020; Faturës nr. 9/7/2020, e datës 07.07.2020; Faturës nr. 9/6/2020, e datës 18.06.2020; Faturës nr.

9/3/2020, e datës 02.03.2020; Faturës nr. 9/2/2020, e datës 11.02.2020; Faturës nr. 9/10/2019, e datës 04.10.2019; Faturës nr. 9/10/2019, e datës 01.10.2019; Faturës nr. 9/9/2019, e datës 01.09.2019; Faturës nr. 9/8/2019, e datës 01.08.2019; Faturës nr. 092-07/19-009, e datës 03.07.2019; Faturës nr. 092-06/19-009, e datës 03.06.2019; Faturës nr. 092-05/19-009, e datës 06.05.2019; Faturës nr. 092-04/19-009, e datës 01.04.2019; Faturës nr. 092-03/19-009, e datës 07.03.2019; Faturës nr. 092-02/19-009, e datës 21.02.2019; Faturës nr. 092-01/19-009, e datës 31.01.2019; Faturës nr. 092-12/18-009, e datës 31.01.2019; Faturës nr. 092-11/18-009, e datës 31.01.2019, si dhe Faturës nr. 092-10/18-009, e datës 31.01.2019, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr. 843/21, të datës 27.04.2021, me të cilin është urdhëruar debitori që kreditorit t'ia paguaj borxhin e përcaktuar sipas faturave në shumë prej EUR 12,118.01, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e dorëzimit të faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarrimore nga neni 71 par.1 nën par.1.1. Tutje thekson se urdhri përmbarrimor përmban të meta nga neni 38 i LPP-së për shkak se në dispozitivin për përmbarrim nuk përcaktohet qartë dhe konkretisht kërkesa për përmbarrim dhe dokumenti i besueshëm në bazë të së cilit kërkohet përmbarrimi, si dhe nuk janë dorëzuar origjinal apo kopje të vërtetuar dokumentet. Më tej, shton se në propozim për përmbarrim janë cekur 20 fatura që secila nga ato është lëshuar në emër të qirasë për muajt përkatës dhe përmban shumën prej EUR 417.28 bruto, e që shuma e tërësishme e faturave rezulton të jetë EUR 8,365.40 dhe jo EUR 12,118.01, sa përcaktohet në dispozitat e urdhrin përmbarrimor. Në fund, ka shtuar se përcaktimi i kohës se kur është krijuar detyrimi i pretenduar dhe kur është bërë i arritshëm për pagesë përbën rendësi në aspektin e parashkrimit, sepse ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbarrimi dhe se obligimet e krijuara për vitin 2018 janë parashkruar në kuptim të nenit 356 të LMD-së. Andaj, gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovet si i bazuar, urdhri përmbarrimor të shfuqizohet.

Së bashku me prapësim, ka paraqitur edhe kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimin, me arsyetim se debitori personalisht nuk e ka pranuar urdhrin përmbarrimor dhe për të njëjtin është vënë në dijeni me datë 11.06.2021, ndërsa debitori nuk ka qenë i njoftuar për urdhrin përmbarrimor nga personi i cili e ka pranuar pa autorizim.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit, pasi që faturat janë dorëzuar në origjinal dhe të nënshkruara, vulosura nga debitori. Më tej, shton se e kundërshton dhe pretendimin e debitorit se kërkesa për pagimin e borxhit është parashkruar, pasi që e njëjta nuk është parashkruar dhe nuk ka arritur afatin tre vjeçar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ashtu që urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi, si dhe shpenzimet e procedurës.

Fillimisht, gjykata ka vlerësuar afatshmërinë e prapësimin dhe bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht fletë kthesën për dorëzim personal gjeti se debitori Urdhrin përmbarrimor P.nr. 843/21 të datës 27.04.2021, e ka pranuar me datë 17.6.2021, ndërsa prapësimin e ka paraqitur në po të njëjtën datë dhe rrjedhimisht brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 70 të LPP-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa pika 1.3 e po të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat e përshkruara si në hyrje të arsyetimit të këtij aktvendimi, mbi bazën e së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, ngase në faturë nuk është përcaktuar qartë detyrimi i debitorit. Përkatësisht, faturat rezultojnë të jetë lëshuar në emër të kërkesave nga qiratë mujore ku është paraqitur edhe vlera prej EUR 417.27 në emër të qirasë mujore, mirëpo në secilën faturë është pasqyruar si obligim i debitorit pagesa e tërë borxhit të akumuluar në emër të qirave mujore paraprake, mirëpo pa u përcaktuar saktë për cilën periudhë kohore është akumuluar ky borxh duke bërë të pamundur për gjykatën të vlerësoj edhe pretendimet materiale

për parashkrim të kërkesës së kreditorit. Andaj, duke qenë se objekt i faturës janë kërkesat nga qiraja të cilat janë natyrës periodike, ndërsa në të njëjtat fatura është pasqyruar borxhi i akumuluar, si të tilla, faturat nuk janë të përshtatshme për përmbarrim.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit Përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi duke hedhur kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme të debitorit për shkak të humbjes së afatit për ushtrimin e prapësimit për arsyet si në vijim:

Me nenin 129.1 të LPK-së përcaktohet se *“Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t’i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen”*. Nga dispozita e lartcekur del se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme mund të paraqitet vetëm në rastet kur pala lëshon afatin për kryerjen e një veprimi procedural të lidhur për afat, e të cilin veprim nuk mund ta ushtroj pas kalimit të këtij afati.

Meqenëse në këtë çështje përmbarrimore u vërtetua se debitori ka parashtruar prapësim brenda afatit prej shtatë (7) ditëve nga dita kur i është dorëzuar urdhri përmbarrimor, atëherë Gjykata gjeti se erdhi në përfundim se kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme e parashtruar nga debitori është e palejuar, për faktin se debitori nuk ka lëshuar afatin për kryerjen e veprimit procedural, përkatësisht parashtrimin të prapësimit ndaj Urdhrit Përmbarrimor P.nr. 843/21, të datës 27.04.2021.

Gjykata rikujton se me nenin 2.4 të LPK-së përcaktohet se *“Pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe për veprimet procedurale tjera që mund të kryhen në procedurë”*. Në kuptim të kësaj dispozite rezulton se debitori nuk ka interes juridik për parashtrimin e kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme për shkak të humbjes së afatit për paraqitjen e prapësimit ndaj urdhrit përmbarrimor, përderisa siç u konstatua më lartë, i njëjti veçse ka ushtruar prapësimin brenda afatit ligjor.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1269/22, datë 03.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.